



Thirrje për Koreograf

Shkodër, 14/03/2019

Pozicioni: Koreograf për Dance Teatër
Titulli i projektit: Arti kundër dhunës
Afati përfundimtar i aplikimit: dt 23/03/2019
Periudha e angazhimit: Dhjetor 2018 – Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Arti kundër dhunës” zbatohet në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Bashkia Shkodër, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri, është bashkëfinancuese dhe bashkëzbatuese e programit, për projektet që po zbatohen në territorin e Bashkisë. Projekti “Arti kundër dhunës” përfshin aktivitete të ndryshme, të cilat materializohen në organizimin e mësimeve jo-formale argëtuese me të vegjël të qytetit (arte figurative dhe muzikë), si edhe me organizimin e një sërë aktiviteteve artistiko-sportive (koncerte, ekspozita, teatër, etj.) me të rinjtë dhe shtresat vulnerabël.

2. Qëllim i kontratës

Qëllimi i kontratës është përgatitja dhe vënia në skenë e 3 shfaqjeve teatrale të cilat trajtojnë problematikën që hasen nga femrat që janë viktime të dhunës. Koreografi do të sigurojë përgatitjen artistike të balerinëve dhe, në bashkënim me regjizorin dhe skenaristin, do të përgatisë koreografinë e shfaqjes. Shfaqjet teatrale do të vihen në skenë në qytetin e Shkodrës.



3. Detyrimet e koreografit

Aktiviteti i koreografit nis menjëherë pas nënshkimit të kontratës.

Ai është përgjegjës për realizimin e koreografisë së shfaqjes dhe mbarëvajtjes së provave me balerinët. Koreografi duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me regjizorin në funksion të përgatitjes së koreografisë dhe të dakortësohet me të përsa i përket realizimit të kësaj të fundit. Lidhur me çdo problematikë të mundshme, koreografi duhet të raportojë tek Fondacioni “ARTE”.

6. Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata nis menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe mbaron në 30 Maj 2019.

7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

i. të detyrueshme

- a. Kandidati duhet të zotërojë diplomë Bachelor në Koreografi/Kërcim, ose të jetë duke ndjekur studimet në Koreografi/Kërcim.
- b. Te ketë eksperiencë të ngjashme në aktivitete artistike;
- c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë;
- d. Të jetë i aftë për punë.

ii. të preferueshme

Të jetë banor në Shkodër.

8. Dokumentacioni

- Letër motivuese;
- Jetëshkrimi (CV), ku të përfshihen eksperiencat e punës;
- Kopje e ID;



- Fotokopje e Diplomës (nëse ka);
- Vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore “i aftë për punë”;
- Vetëdeklarim gjendjen gjyqësore “i padënuar me vendim të formës së prerë”.

Kandidatët që shpallen fitues duhet të dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar nga kontraktuesi dokumentacioni si më poshtë:

- Vërtetim banimi;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi e gjendjes shëndetësore

9. Pagesa

Pagesa për Koreografin do të realizohet sipas kontratës që do të lidhet me Fondacionin Arte.

10. Aplikimi

Aplikimi duhet të dorëzohet **brenda dt. 23/03/2019**, me email në:

fondacioniarte@gmail.com

ose

me postë, në adresën zyrtare të Fondacionit ARTE

Rruga e Kavajës, Pallati 223, Shkalla 3, Kati 4, Apartamenti 23, Tiranë

Përgjigja e rezultateve jepet me email pas tri - pesë ditëve, që nga përfundimi i aplikimit. Kandidati duhet të paraqitet pranë Fondacionit ARTE për nënshkrimin e kontratës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.